



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE

ADRESA SHESHI “RILINDJA”

TEL 08122225 ;22 32 FAX

08122225 e-mail: bashkia.kolonje@gmail.com

Nr _____ Prot
2019

Kolonjë me ____/____/

MIRATOHET

**Kryetari
Ilia STEFO**



TERMAT E REFERENCËS

TERMAT E REFERENCËS DHE FONDIT LIMIT PËR

HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT PËR PJESËN E EKONOMITË PYJORE
“ÇLIRIM”

PËRMABJTJA

1. TË PËRGJITHSHME

1.1 Pjese te Ekonomise Pyjore “Çlirim”

2. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT

2.1 Fondi limit për planin e mbarështimit të EP “Çlirim”

2.4 Fondi total për hartimin e planit të mbarështimit

3. TERMAT E REFERENCËS

3.1 Detyrat që ndiqen për hartimin e planit të mbarështimit

3.2 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të planit të mbarështimit

3.3 Përmbajtja e Plani të mbarështimit të Ekonomisë Pyjore

4. AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

5. STAFI DHE EKSPERIENCA

6. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

7. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

8. REFERENCA LIGJORE

1. TË PËRGJITHSHME

Në kuadër të reformës administrativo-territoriale, Bashkisë Kolonje nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, i kanë kaluar në pronësi sipërfaqet e fondit pyjor në territorin e Bashkisë.

Duke patur parasysh se planet e Inventarizimit (Mbarështimit), janë hartuar në vitin 1985, gjatë këtyre viteve në këto ekonomi pyjore kanë ndodhur ndryshime të mëdha, të cilat kanë ardhur si rezultat i shfrytëzimeve të lëndës drusore, ndërhyrjeve të paligjshme, dëmtimet nga rënia e zjarreve, zënia e sipërfaqeve pyjore me anë të shpyllëzimeve, etj., si në sipërfaqe dhe volum, të cilat nuk janë pasqyruar në regjistrat kadastral të fondit pyjor ndër vite.

1.1 Pjesa e Ekonomia Pyjore “Çlirim”

Kjo pjesë e ekonomi pyjore shtrihet në Njësitë Administrative Çlirim dhe në Veri me fshatin Qesarake në Jugl kufizohet lumin Osum në lindje me fshatin Luaras.

Në këtë pjesë të ekonomisë pyjore mbizotërojnë llojet pyjore si: Lisi e Shkoza të cilat kanë potencialin me të madh për tu shfrytëzuar, kryesisht për prodhimin e druve të zjarrit.

Në pasqyrën e mëposhtme, jepen të dhënat e pjesës së ekonomisë pyjore sipas formës së përdorimit të territorit të sipërfaqes që zënë sipas zërave.

Pjesa e Ekonomise Pyjore	Përdorimi i Teritorit		Sipërfaqja në (Ha)
"Çlirim"	Pyll	Trungishte	16.5
		Cungishte	531.25
		Shkurre	
		Totali	547.75
	Kullota, livadhe		
	Djerr		
	Inproduktive		24.75
	Tokë me bimësi pyjore		
	Ujore		
	Totali i pjeses se ekonomisë pyjore		572.5

2. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përllogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit/eve që do të hartojnë planin e ri të mbarështimit të pjeses së ekonomive pyjore.

Përllogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit është realizuar mbështetur në VKM-në Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik”, e cila paraqitet në pasqyrat e mëposhtme sipas ekonomive pyjore.

2.1 Fondi limit për planin e mbarështimit të pjeses së EP “Çlirim”

Fondi limit për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Fag” është përllogaritur në vlerën e 1 000 000 (një milion) lek pa TVSH dhe 1 200 000, (një milion e dyqind mijë) lekë me TVSH

Ekonomia Pyjore	Forma e qeverimit	Sipërfaqja (ha)	Çmimi për njësi lekë/ha	Vlera totale lekë
“Fag”	Trungishte (Klasa IV e lartë e moshës)	16.5		
	Trungishte (Klasa I-III e moshës)			
	Cungishte	547.75		
	Shkurre			
	Kullota, livadhe			
	Tok me bim. pyj+Inprod.+djerr+tjera	24.75		
Totali i ekonomisë pyjore		572.5		
TVSH 20 %				
T O T A L I				

3. TERMAT E REFERENCËS

Termat e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve të miratuar nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave me Udhëzimin nr. 1, datë 28.03.2001.

Manuali përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të perpunimit të dhënave në zyrë.

3.1 Detyrat që ndiqen për hartimin e planit të mbarështimit

Detyrat që duhet të zbatojë subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve janë:

Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonominë pyjore;

Përshkrimi i përgjithshëm në terren i ngastrave e n/ngastrave, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse;

Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes:

- Trungishte
- Cungishte
- Shkurre

Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës;

Vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta);

Identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve;

Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë;

Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zonës;

Eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zonës;

Hartografimi i territorit të zonës (në GIS), duke përfshirë:

Ekonominë pyjore, ndarjen e ngastrave e të n/ngastrave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes;

Përdorimin e territorit të zonës;

Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve;

Rrjetin e përhershëm dhe të përkohshëm të sipërfaqeve provë;

Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të planit të mbarështimit;

Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellësi;

Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivit kryesor të menaxhimit për ekonominë pyjore;

Hartimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe planit të veprimit;

Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë;

Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre;

Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të menaxhimit me palët e interesuara;

Konsultimi i draft-planit të menaxhimit me aktorët vendimarrës (Bashkia Kolonjë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat etj).

Recensime të draft-planit të përgatitur;

Ripunim materiali pas vërejtjeve të bëra.

3.2 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të planit të mbarështimit

Objektivi i përgjithshëm i planit të mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Kolonje (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifike të planit të mbarështimit do të jenë:

Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat;

Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë;

Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve;

Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor;

Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues;

Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues;


Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit;

Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve, dhe prerjeve të paligjshme;

Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore;

Sigurimi i pjesëmarjes së gjërë të popullsisë lokale në marjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullovave;

Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.



3.3 Përmbajtja e Plani të mbarështimit të pjesës së Ekonomisë Pyjore

1. HYRJE

- 1.1 Arsyet dhe objektivat e planit të mbarështimit.
- 1.2 Detyra e projektuesit
- 1.3 Radha e operacioneve dhe përgjegjësitë
- 1.4 Metodatat e Punës
- 1.5 Materiali informativ i përdorur
- 1.6 Objektivat e përgjithshme të mbarështimit

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË

- 2.1 Shënime të përgjithshme
- 2.2 Pronësia, administrimi, organizimi
 - 2.2.1 Pronësia
 - 2.2.2 Shtirja administrative, ndarja administrative
 - 2.2.3 Administrimi, organizimi
 - 2.2.4 Kushtet e punës
 - 2.2.5 Të drejtat e përdorimit
- 2.3 Historiku i mbarështimit
- 2.4 Gjendja e përgjithshme social-ekonomike
- 2.5 Gjendja ekologjike
 - Sipërfaqet pyjore që janë me potencial të mirë prodhues
- 2.6 Gjendja e tregut të materialeve drusore dhe jo drusore
- 2.7 Kufizimet
- 2.8 Gjuetia dhe peshkimi

3. GJENDJA AKTUALE E PYLLIT

3.1 Mbarështimi dhe funksionet

3.1.1 Tipet e përdorimit të tokës

3.1.2 Forma e qeverisjes

3.1.3 Funksionet kryesore

3.1.4 Ndarja e pyjeve (Ngastra, n/ngastra)

3.2 Përshkrimi i stacionit

3.2.1 Klima

3.2.2 Topografia

3.2.2.1 Lartësia mbi nivelin e detit

3.2.2.2 Kundrejtimi

3.2.2.3 Pjerrësia

3.2.2.4 Relievi

3.2.2.5 Pasojat për mbarështimin

3.2.3 Faktorët edafikë

3.2.3.1 Petrografia

3.2.3.2 Tipet e tokës

3.2.3.3 Prezenca e gurëve

3.2.3.4 Hidrografia

3.2.3.5 Erozioni

3.2.3.6 Përmbledhje dhe pasojat për mbarështimin e pyllit

3.3 Biodiversiteti

3.3.1 Shkalla e natyralitetit të pyllit

3.3.1.1 Tipet aktuale të vegjitacionit

3.3.1.2 Tipet potenciale të vegjitacionit



- 3.3.1.3 Shkalla e natyralitetit të pyllit
- 3.3.2 Biotopet e veçantë
- 3.3.3 Habitatet specifike
- 3.3.4 Llojet e kërcënuara
- 3.3.5 Rreziqet për biodiversitetin
- 3.3.6 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështim
- 3.4 Funksionet e veçanta aktuale
 - 3.4.1 Prodhimi (përfshirë gështenja etj.)
 - 3.4.2 Mbrojtja
 - 3.4.3 Ruajtja e natyrës
 - 3.4.3.1 Burimet gjenetike
 - 3.4.3.2 Të tjera
 - 3.4.4 Rekreacioni
 - 3.4.5 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështim
- 3.5 Analiza e grumbullit
 - 3.5.1 Analiza e tipit të grumbullit
 - 3.5.2 Të dhënat kryesore për n/ngastër
 - 3.5.3 Shpërndarja e sipërfaqes dhe vëllimit
 - 3.5.3.1 Për pyjet trungishte
 - 3.5.3.2 Për pyjet cungishte
 - 3.5.3.3 Për shkurret
 - 3.5.4 Rezultatet e inventarizimit
 - 3.5.4.1 Rezultatet sipas shtresave
 - 3.5.4.2 Analiza statistikore e inventarizimit
 - 3.5.5 Analiza silvikulturale



- 3.5.6 Intesiteti i ndërhyrjeve
- 3.5.7 Struktura e grumbullit
- 3.5.8 Ripërtëritja natyrale
- 3.5.9 Cilësia e lëndës në këmbë
- 3.5.10 Rritja
- 3.5.11 Krahاسimi i grumbullit me “pyllin normal”
- 3.6 Gjëndja fitosanitare
 - 3.6.1 Drurë të kalbur dhe shkaqet
 - 3.6.2 Dëmtimet në pyll
 - 3.6.3 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështimin
- 3.7 Prerjet ilegale
 - 3.7.1 Gjendja aktuale
 - 3.7.2 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështimin
- 3.8 Bimësia barishtore
- 3.9 Kullotat
 - 3.9.1 Tipi dhe cilësia
 - 3.9.2 Përdoruesit/koha
 - 3.9.3 Prodhimi i biomasës
 - 3.9.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti
 - 3.9.5 Problemet (mbikullotja, kullotja ilegale në pyje etj)
 - 3.9.6 Vlerësimi i përgjithshëm dhe pasojat për mbarështim
- 3.10 Gjahu dhe gjuetia.



4. VLERËSIMI I MBARËSHTIMIT TË MËPARSHËM

- 4.1 Të përgjithshme
- 4.2 Vlerësimi i zbatimit të masave të planifikuara
 - 4.2.1 Masat silvikulturale
 - 4.2.2 Mundësia e shfrytëzimit
 - 4.2.3 Kriteria të tjera
 - 4.2.4 Pasojat kryesore për mbarështimin e ardhshëm dhe arritjen e objektivave

5. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT

- 5.1 Objektivat kryesore
- 5.2 Objektivat specifike për ekonominë pyjore
 - 5.2.1 Përdorimi i territorit, forma e qeverisjes, funksionet
 - 5.2.2 Tipi i grumbullit
 - 5.2.3 Objektivat silvikulturale
 - 5.2.4 Kullotat
 - 5.2.5 Biodiversiteti dhe habitatet kryesore të florës dhe bimësisë së zonës, bazuar në kategorizimet e Natyra 2000
 - 5.2.6 Gjëndja shëndetësore/Prerjet ilegale
 - 5.2.7 Mbarështimi i gjahut
 - 5.2.8 Objektiva të veçanta për funksionin prodhues
 - 5.2.9 Objektiva të veçanta për funksionin mbrojtës
 - 5.2.10 Objektiva të veçanta për pyjet e mbrojtur
 - 5.2.11 Objektiva të veçanta për funksionin rekreativ
 - 5.2.12 Objektivat të veçanta për mundësinë e shfrytëzimit

6. MASAT PËR MBARËSHTIMIN E PYLLIT

- 6.1 Mundësia vjetore e shfrytëzimit
 - 6.1.1 Mundësia vjetore silvikulturale
 - 6.1.2 Metodat e llogaritjes dhe arsyet për zgjedhjen e prerjes vjetore
 - 6.1.3 Vlerësimi i pasojave të realizimit
 - 6.1.4 Vlerësimi mjedisor
 - 6.1.5 Prerjet e lejueshme përfundimtare
- 6.2 Masat për shfrytëzim
- 6.3 Masat silvikulturale në pyjet e lartë
 - 6.3.1 Përgatitja e tokës
 - 6.3.2 Pyllëzimet
 - 6.3.3 Kujdesimet < 10 m
 - 6.3.4 Rrallimet
 - 6.3.5 Prerje përfundimtare
- 6.4 Masat silvikulturale në cunqishte dhe shkurre
- 6.5 Përmirësimi i kullotave
- 6.6 Masat për biodiversitetin
- 6.7 Gjëndja shëndetësore e pyllit / prerjet ilegale
- 6.8 Mbarështimi i gjahut
- 6.9 Masa specifike për pyjet me funksion prodhues.
- 6.10 Masat specifike për pyjet me funksion mbrojtës
- 6.11 Masat specifike për pyjet e mbrojtur
- 6.12 Masat specifike për pyjet me funksion rekreativ

7. GJENDJA DHE MASAT PËR INFRASTRUKTURËN

- 7.1 Përdorshmëria e infrastrukturës
 - 7.1.1 Gjëndja
 - 7.1.2 Objektivat dhe masat
- 7.2 Transporti
 - 7.2.1 Gjëndja
 - 7.2.2 Objektivat dhe masat
- 7.3 Infrastruktura të ndryshme
 - 7.3.1 Gjendja
 - 7.3.2 Objektivat dhe masat
- 7.4 Infrastruktura për rekreacion
 - 7.4.1 Gjendja
 - 7.4.2 Objektivat dhe masat
- 7.5 Infrastruktura mbrojtëse
 - 7.5.1 Gjendja
 - 7.5.2 Objektivat dhe masat
- 7.6 Infrastruktura për mbrojtjen nga zjarri
 - 7.6.1 Gjendja
 - 7.6.2 Objektivat dhe masat
- 7.7 Infrastruktura të tjera
 - 7.7.1 Gjendja
 - 7.7.2 Objektivat dhe masat
- 7.8 Vlerësimi mjedisor i ndikimeve nëse është e nevojshme

8. PLANIFIKIMI EKONOMIK

- 8.1 Volumi i punës dhe kapaciteti



- 8.2 Prashikimi i të ardhurave
- 8.2.1 Parashikimi i kostos
- 8.2.2 Parashikimi i fitimit ose humbjes (përfitime-shpenzime)
- 8.2.3 Vlerësimi i efekteve pozitive të pyllit të pa llogaritshme në vlerë

9. INDIKATORËT PËR MONITORIM DHE VLERËSIM

- 9.1 Indikatorët afat shkurtër (vjetor)
- 9.2 Indikatorët afat mesëm
- 9.3 Indikatorët për mbarështimin e qëndrueshëm të pyllit

10. UDHËZIME PËR REVIZIONIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT

11. PLANI 10 VJEÇAR I PUNIMEVE TË PROPOZUARA SIPAS KATEGORIVE TË PUNIMEVE

PJESA E DYTË (Përshkrim parcellar)

- 12. Lista e ngastrave, n/ngastrave me të dhënat kryesore
- 13. Lista e nëngastrave në rend numerik dhe analfabetik
- 14. Udhëzuesi për përshkrimin parcellar

PJESA E TRETË

- 15. INVENTARIZIMI
- 15.1. Rezultatet e sipërfaqeve provë.
- 15.2. Sipërfaqet provë të renditura sipas ngastrave
- 15.3. Sipërfaqet provë në rend numerik

- 15.4 Analizën statistikore
- 15.5 Formularët e terrenit
- 15.6 Harta me rrjetin e sipërfaqeve provë
- 15.7 Udhëzuesi për inventarizimin me sipërfaqe provë

PJESA E KATËRT

16. HARTAT

- 16.1 Harta e gjendjes ekzistuese (përdorimi i territorit)
- 16.2 Harta e punimeve të propozuara
- 16.3 Harta e përhapjes së llojeve drusore
- 16.4 Harta e ekonomisë pyjore sipas nën/ngastrave (Ortofoto)
- 16.5 Harta e shtrirjes së sipërfaqeve prove të përhershme dhe të përkohshme

Hartat që do të përgatiten nga kontraktori në kuadër të planit të mbarështimit duhet të jenë të dixhitalizuara, të gjeoreferuara, me të gjitha elementët identifikues (kuota, rrjeti rrugor, rrjeti hidrik, emërtesat e vendeve, kufijtë e zonave të mbrojtura, izoipset kryesore etj) në shkallën 1:10 000 dhe 1:25 000.

Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e planit të mbarështimit do të bazohet në Manualin e Mbarështimit të pyjeve për inventarizimin e ekonomive pyjore me sipërfaqe prove të përhershme dhe të përkohshme e përkrahimin parcellar, miratuar nga Këshilli Shkencor të ish- Institutit të Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave, me Udhëzimin Nr 1 datë 28.3.2001

Plani i mbarështimit i hartuar nga kontraktori së bashku me hartat pyjore dhe dokumentacioni shoqërues do të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor në 4 kopje të printuara dhe 4 kopje në format elektronik (CD).

Cilësia e materialeve që do të përdoren për printimin e planit të mbarështimit dhe hartave duhet të jete më tërësisht më të mirë të ofruar në treg. Hartat do të vishen me material plastik rezistues ndaj ujit.

4. AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

Për realizimin e hartimit të planit të mbarështimit për këto ekonomi pyjore parashikohet një afat kohor 10 mujor që fillon me nënshkrimin e kontratës me subjektin e kontraktuar. Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar.

Kalendari i punimeve

Nr.	Aktiviteti	Muaji		
		1	2	3
1	Punime përgatitore			
2	Punimet e terrenit			
3	Punimet e zyrës			
4	Përgatitja Draft Planit			
	RAPORTIMET			
1	Informacion për punën e realizuar			
2	Dorëzimi i skedave të përshkrimit parcelar			
3	Raporti i përkohshëm, punimet e terrenit			
4	Dorëzimi i skedave të inventarizimit dhe CD me të dhënat e përpunuara në kompjuter			
5	Dorëzimi i Draft Planit të Mbarështimit			
6	Raportimi përfundimtar			
7	Diskutim me aktorët e fushës dhe mbrojtja e Draft Planit			
8	Dorëzimi i Planit të ri të Mbarështimit			

5. STAFI DHE EKSPERIENCA

Subjekteti i kontraktuar duhet të jetë i pajisur me licencë të kategorisë III.7, sipas shtojcës së ligjit për licencat dhe duhet të ketë në përbërje staf pune të kualifikuar për hartimin e planit të mbarështimit, me eksperiencë minimale 10 vjet në fushat respektive të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.

Stafi i kontraktorit do të ketë në përbërje specialistë të profileve si më poshtë:

Inxhinier Pyjesh, i cili është dhe kryetar grupi (i licencuar)

Specialist Pyjesh (Inxhinier/Teknik Pyjesh)


Topograf i licencuar

Petolog

Biolog

Sociolog

Eksperiencia e punës dhe profilet e specialistëve do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me kontratat individuale të punës (e vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.



6. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Autoriteti kontraktor do të monitorojë fazat e ndryshme të hartimit të planit të mbarështimit dhe punimet që realizohen nga subjekti kontraktor nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Grupi i monitorimit do të ketë në përbërje 3 specialistë të pyjeve (inxhinier pyjesh) nga agjensia e pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Kolonjë, të cilët do të monitorojnë procesin e hartimit të planit të mbarështimit nga subjekti i kontraktuar në lidhje me:

Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në përgjithësi;

Përmbushjen e kërkesave të manualit të mbarështimit të pyjeve për punimet e terrenit dhe ato të

zyrës;

Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në lidhje me numrin e punonjësve dhe kualifikimet profesionale të stafit të përfshirë në proces nga kontraktori;

Respektimin e kriterëve tekniko-ligjore nga kontraktori gjatë procesit të hartimit të planit të mbarështimit;

Zbatimin e afateve kohore për realizimin e fazave dhe aktiviteteve nga kontraktori të përcaktuara paraprakisht;

Detyrime të tjera të kontraktorit.

Grupi i monitorimit gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, njofton me shkrim titullarin e autoritetit në lidhje me problematikat që konstaton gjatë procesit të hartimit të planit të mbarështimit si dhe sugjeron masat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe tekniko-ligjore nga ana e kontraktorit.

7. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore i hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët e fushës (Nj.A. shoqatat e pyjeve, komunitetit) do të miratohet nga komisioni i agjensisë së pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Kolonjë dhe do të dërgohet zyrtarisht për konfirmim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Në zbatim të parashikimeve të ligjit “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, plani i mbarështimit pasi të konfirmohet nga ministria përgjegjëse për pyjet, do të përcillet në Këshillin Bashkiak për miratim përfundimtar.

Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore do të merret në dorëzim nga përfaqësuesit e autoritetit kontraktor pasi të jetë marrë konfirmimi nga Ministria përgjegjëse për pyjet.

8. REFERENCA LIGJORE

Gjatë hartimit të këtij projekti janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e menaxhimit të pyjeve dhe në fushën e prokurimit publik.

Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

Ligji Nr. 9385 datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar;

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 433, date 08.06.2016 për “Transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik”;

Manuali i Mbarështimit të Pyjeve miratuar nga Këshilli shkencor pranë Institutit të Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave me Udhëzimin Nr. 1, datë 28.03.2001;

Komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, DETYRA E PROJEKTIMIT

